



PËRMBLEDHJE NË LIDHJE ME NDRYSHIMET E PROPOZUARA NË RREGULLOREN KPM-2016/01

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM në mbledhjen e mbajtur më datën 31 janar 2020, vendosi që në respektim të nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-44 të KPM-së të shpall për diskutim publik Rregulloren KPM-2016/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale. KPM, qëllim që palëve t'i ofrohen sqarime në lidhje me propozim-ndryshimet në Rregulloren KPM-2016/01, si pjesë të diskutimit publik, se bashku me Rregulloren KPM-2016/01, publikon edhe këtë Memo Sqaruese.

Pjesët të cilat janë propozuar për ndryshime në raport me Rregulloren në fuqi ndërlidhen me nenet e mëposhtme:

NENI 5

- Është shtuar paragrafi 7, që përcakton se ndërprerja e veprimtarisë për një periudhë më të gjatë se tre (3) muaj do të rezultojë me ndërprerje të licencës. Kjo për shkak të rasteve kur OSH-të janë licencuar dhe nuk kanë filluar veprimtarinë e tyre për kohë të gjatë, duke mos e ushtruar fare veprimtarin me platformën e licencuar.
- Gjithashtu janë shtuar paragrafët 8 dhe 9, për shkak se sipas Rregullores në fuqi, të gjitha marrëveshjet mbi të drejtën e autorit duhet të jenë të regjistruara në shoqatat për administrim kolektiv dhe përderisa këto shoqata ende nuk janë funksionalizuar, nuk duhet të ketë barriera për OSH-të sa i përket pranimit të marrëveshjeve të të drejtave të autorit nga KPM-ja. Në të kundërtën, do të pamundësohej operimi i OSH deri në funksionalizimin e këtyre shoqatave.

NENI 8

- Tek neni 8 është shtuar paragrafi 2, për shkak se Rregullorja në fuqi ka përcaktuar që kërkesa e OSH-ve për ripërtëritje të licencës duhet të bëhet të paktën gjashtë (6) muaj dhe jo më vonë se 60 ditë muaj **para** skadimit të saj. Përmes paragrafit 2 është caktuar një afat objektiv prej 6 muajve në mënyrë që mos të ketë kufizime minimalmirëpo OSH-të në bazë të rrethanave dhe kushteve të tyre, të kenë mundësi të bëjnë kërkesë për ripërtëritje gjatë kësaj periudhe.

NENI 9

- Tek neni 9, paragrafi 2, është propozuar që statusin e bartjes së obligueshëm, krahas dy kanaleve të transmetuesit publik, ta gëzojnë vetëm OSHMA-të (TV) me transmetim tokësor. Kjo për shkak që të sigurohet që këto OSHMA, që shpërndajin brezin frekuencor si të mira të limituara publike, janë të qasshme për publikun duke pasqyruar edhe faktin që shfrytëzimi i OSH-ve nga publiku është gjithnjë në rritje, ndërsa pranimit i sinjalit tokësor në mënyrë tradicionale (përmes antenës) është duke u zvogëluar. Ky paragraf konsiderojmë se është i favorshëm sidomos për TV me transmetim lokal dhe regional. Ndërsa, OSHMA-ve që operojnë jashtë brezit frekuencor i është lënë mundësia e zhvillimit të raporteve komerciale në mes tyre dhe OSH-ve, kjo me qëllim të mundësive për zhvillim të tyre. Po ashtu, kërkesa të tilla për lejimin e zhvillimit të raporteve komerciale në mes OSHMA-ve dhe OSH-ve janë dorëzuar në KPM edhe nga disa të licencuar të KPM-së, Oda Ekonomike Amerikane dhe Oda Ekonomike e Kosovës.
- Paragrafi 7, i nenit 9, i Rregullores në fuqi është hequr dhe janë shtuar, tri (3) paragraf (7, 8 dhe 9). Paragrafi 7 dhe 8 përcakton se OSHMA-të e gëzojnë statusin e bartjes së obligueshme vetëm brenda zonës së tyre të mbulimit me transmetim tokësorë, kurse paragrafi 9 përcakton se Lista e OSHMA-ve me statusin e bartjes së obligueshme do të ofrohet nga KPM.

NENI 10

- Neni 10 i Rregullores në fuqi është fuzionuar në nenin 9 të draft Rregullores. Ndërsa, është shtuar si nen i veçantë neni 10 i cili ka të bëjë me obligimet e OSHMA-ve që nuk gëzojnë statusin e bartjes së obligueshme, sa i përket kushteve të bartjes në Operatoret e Shpërndarjes.
- Është hequr përqindja e programit si kriter për bartje të obligueshme i përcaktuar me nenin 10 të Rregullores në fuqi, për shkak se është propozuar që statusin e bartjes së obligueshme ta gëzojnë vetëm OSHMA me transmetim tokësor, për shkak të arsyeve të lartpërmendura. Gjithashtu, konsiderojmë se përcaktimi i kuotës prej 25% sic parashihet me rregulloren 2016/01, është më shumë përcaktim kufizues se sa inkurajues e zhvillimorë, sidomos për OSHMA-të të cilat janë në zhvillim e sipër.

NENI 11

Është shtuar paragrafi 3, sipas të cilit obligohen OSH-të, përkatësisht Këshilli Programor, që renditja e kanaleve të bëhet në grupime bazuar në natyrën e përmbajtjes së kanaleve, p.sh. grupi i kanaleve me përmbajtje gjeneralistike, kanalet për fëmijë, sport, etj.. Grupimet bëhet sipas vlerësimeve të Këshillit Programor të OSH-së.

NENI 12

- Paragrafi 5, i nenit 12, është hequr nga Rregullorja, për arsye që paragrafi pasues i tij trajton të njëjtën çështje.

NENI 14

- Neni 14 i Rregullores në fuqi është fuzionuar në nenin 15 të draft rregullores, për arsye se behët fjalë për të njëjtën çështje, mbrojtjen e përdoruesve.

NENI 15

- Janë shtuar dy paragraf (5 dhe 10) që po ashtu kanë të bëjnë me masat për mbrojtje të përdoruesve. Me anë të paragrafit 5 përcaktohet afati për informim të publik për ndryshime sa i përket tarifave dhe kushteve tjera të shërbimeve të ofruara nga ana e OSH-ve. Ndërsa, sipas paragrafit 10 është propozuar që OSH-të të mbajnë të dhëna rreth ankesave nga përdoruesit dhe veprimet e ndërmarra për zgjidhjen e tyre nga OSH-të.

Sqarim: Inicimi i këtij drafti është bërë pas vlerësimeve të KPM-së si dhe vështirësive gjatë implementimit të Rregullores 2016/01ku edhe jemi ballafaquar më sfidat e paraqitura gjatë implementimit të kësaj rregulloreje, kërkesave nga të licencuarit e KPM-së dhe palët tjera të interesit. Është vlerësuar se Rregullorja në fuqi ka paraqitur pengesë edhe për zhvillimin e raporteve komerciale në mes të aktereve në tregun medial dhe kjo ka ndikuar negativisht në fuqizimin e televizioneve vendore si prodhues të përmbajtjeve programore. Ndryshimi i rregullores është mbështetur edhe nga Oda Ekonomike e Kosovës; Oda Ekonomike Amerikane si dhe të licencuar tjerë të KPM-së, duke mos i përjashtuar edhe kundërshtimet e operatorëve të shpërndarjes të cilët janë kundër përjashtimit të televizioneve kabllore nga rregulli Must Carry (bartja e detyrueshme). Gjithashtu në draftin e Rregullores janë bërë ndryshime sa i përket terminologjisë, me qëllim të harmonizimit me Ligjin e KPM-së dhe Direktivën për Shërbimet Mediale Audiovizuale të BE-së.

Kjo Draft-Rregullore i është nënshtruar diskutimit publik, brenda periudhës kohore janar-qershor 2020.

Gjatë periudhës se diskutimit publik janë pranuar komento nga këto palë:

1. AMPEK;
2. AGK;
3. Ipko;
4. Kujtesa NET; Telkos; Bledi; Fiberlink; ISP Broadcast; Max TV; Kadria NET; J@NET; Galaktika; Telecommunications/Kumanova
5. Koscabel;
6. TV Mitrovica;
7. Artmotion;
8. TV Most, TV Herc, TV Puls, TV Kim, TV Kiss, TV Mir, TV Zoom;
9. Oda Ekonomike e Kosovës;

10. Oda Ekonomike Amerikane.

Pas rishikimit të komenteve të pranuar, palët e interesit do të pranojnë përgjigje nga KPM ndaj komenteve të paraqitura.

2020

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE